

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.109/2017, “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”

A. MËNYRA E NDËRRHYRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014, etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijnë¹:

1. *Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;*
2. *Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;*
3. *Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;*
4. *Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.*

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit.

Neni 101 ka parashikuar ‘**nevojën**’ dhe ‘**urgjencën**’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2018. Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës të të cilit lidhet me këto arsye kryesore:

- ✓ *Sigurimin e një shpërblimi për pensionistët dhe familjet në nevojë në fund të vitit;*
- ✓ *rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve publike për rialokimet drejt projekteve të investimeve me progres të mirë deri tani;*
- ✓ *rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit;*

Njëkohësisht, **nevoja dhe urgjenca** konsistojnë edhe në faktin se:

- a) *Alokimi i burimeve drejt projekteve të investimeve publike, të cilat rezultojnë me progres të mirë deri tani, me qëllim arritjen e nivelit të programuar të tyre për vitin 2018.*

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006,

- b) *Bëhet e mundur shlyerja në kohë e detyrimeve financiare kontraktuale të institucioneve buxhetore nëpërmjet rialokimeve buxhetore të këtij akti normativ. Kësisoj reduktohet mundësia e krijimit të detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2018.*
- c) *Një argument tjetër për ndryshimet e bëra është edhe nevoja që Këshilli i Ministrave si ushtruesi më i madh i së drejtës së iniciativës ligjvënëse dhe vetë Kuvendi të veprojnë pa cenuar ekonominë ligjvënëse, që nënkupton se me rastin e ekzistencës së nevojës dhe urgjencës për disa ndryshime në ligjin e buxhetit mund të adresohen njëkohësisht edhe ndryshime të tjera jo domosdoshmërisht urgjente. Një gjë e tillë është logjike e kursimit legjislativ, duke mos angazhuar Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin në procese legjislative të herpashershme dhe të së njëjtës natyrë.*
- ç) *Sistemimi i të ardhurave midis zërave me efekt zero;*
- d) *Miratimi i fondit për shpërblimin e pensionistëve dhe shtresave në nevojë.*

Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, duke ruajtur deficitin në nivele të pandryshueshme e duke forcuar më tej objektivin e qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

B. SITUATA E PËRGJITHSHME FINANCIARE JANAR – QERSHOR 2018

1. Zhvillimet kryesore makroekonomike

Ekonomia e Shqipërisë për pjesën e parë të vitit 2018 tregoi sërish ritme pozitive dhe përshpejtuese të rritjes ekonomike. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) real u rrit me 4.45% në tremujorin e parë të vitit 2018, nga 3.84% që shënonte për të gjithë vitin 2017, duke vijuar trendin mbi katërvjeçar tashmë, që prej vitit 2014 të përshpejtimit të ritmit të rritjes.

Nga optika e ofertës agregate, kontributin kryesor në rritjen për tremujorin e parë të vitit 2018 e kanë dhënë degët: Industria me +2.42 pikë përqindje; Tregtia me shumicë dhe pakicë, etj. me +0.54 pikë përqindje; dhe Bujqësia, pyjet dhe peshkimi me +0.37 pikë përqindje. Pothuajse të gjithë sektorët e ofertës performuan me rritje reale gjatë këtij tremujori, me përjashtim të degëve “Informacion dhe komunikacion” dhe “Aktivitete financiare dhe të sigurimit”.

Nga pikëpamja e shpenzimeve, rritja ekonomike në tremujorin e parë të 2018 u gjenerua nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Konsumi total u rrit me rreth 2.96% në terma realë, po aq edhe ai privat. Gjithashtu, formimi i kapitalit fiks bruto (investimet

totale) gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 u rrit me rreth 5.43%. Ndërkohë kërkesa e huaj, megjithë rritjen reale prej rreth 5.02% të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, sërish dha një kontribut negativ në rritjen e PBB-së për tremujorin e parë të vitit 2018 në reflektim të peshës së lartë të importeve.

Performanca e mirë e ekonomisë reale gjatë vitit 2017 dhe tremujorit të parë u reflektua në mënyrë të qartë edhe në tregun e punës. Në fund të vitit 2017, shkalla e papunësisë ra në 13.6%, ndërsa vijoi të bjerë edhe në T1-2018 në 12.5% duke regjistruar nivelin më të ulët që nga tremujori i parë i vitit 2012. Ndërkohë, punësimi (për popullsinë 15 vjeç e lart) u zgjerua me 3.4% gjatë vitit 2017 ose me rreth 38 mijë të punësuar. Punësimi u zgjerua gjithashtu në T1-2018 me 3.5% krahasuar me T1-2017. Po ashtu forca e punës u zgjerua me 2.4% në terma vjetorë dhe shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore vazhdoi të rritet duke arritur në 67.4% në fund të 2017 krahasuar me 65.7% që ishte në fund të vitit 2016.

Edhe perceptimi i agjentëve ekonomikë mbi ekonominë ka njohur një përmirësim të dukshëm siç dëshmohet nga treguesi i ndjesisë ekonomike. Ky tregues qëndron mbi mesataren afatgjatë që prej T2-2016, dhe vijoi të qëndrojë mbi këtë mesatare edhe për gjysmën e parë të vitit 2018, pavarësisht nga ndryshimet tipike të nivelit të tij midis tremujorëve të ndryshëm.

Në të njëjtën kohë pozicioni i jashtëm i ekonomisë ka njohur përgjithësisht përmirësim. Bilanci i përgjithshëm i pagesave në vitin 2017 shënoi rritje duke arritur vlerën +185.4 milionë euro, nga +48 milionë euro që ishte në vitin 2016. Pra, rrjedhimisht edhe stoku i rezervave valutore vijoi të rritej me këtë vlerë gjatë 2017 duke arritur ekuivalentin e mbi 7 muajsh import mallrash dhe shërbimesh. Ndërkohë që deficiti i llogarisë korrente në përqindje të PBB-së u ngushtua në rreth 7% në vitin 2017 nga 7.6% një vit më parë, ndërkohë që llogaria financiare dhe kapitale për vitin 2017 u zgjerua në vlerën +1,185.8 milionë euro krahasuar me +730.6 milionë euro që ishte në vitin 2016. Për T1-2018 një zhvillim i rëndësishëm ishte sa i takon treguesit të flukseve të investimve të huaja direkte të cilat u zgjeruan me rreth 62% krahasuar me T1-2017, krejtësisht kjo e ndryshme edhe me pritshmëritë fillestare të cilat merrnin në konsideratë ngadalësimin e fazës ndërtuese të dy projekteve të mëdha, atë të TAP dhe hidrocentralit të Devollit.

Konvergimi gradual i ekonomisë drejt potencialit të saj të rritjes duket se ka shtyrë gradualisht edhe nivelin e inflacionit drejt nivelit të targetuar. Kështu, përgjatë periudhës janar-qershor 2018 inflacioni mesatar rezultoi të ishte në nivelin 2.1%, ndërsa vetëm për muajin qershor 2018 inflacioni arriti në 2.4%.

2. Zhvillimet kryesore fiskale

Të ardhurat e buxhetit në 6-mujorin e parë 2018

Në gjashtëmujorin janar-qershor 2018 janë arkëtuar gjithsej në buxhet 217 miliardë lekë, rreth 5 miliardë lekë më shumë ose +2.22 % mbi nivelin e 6-mujorit të vitit 2017. Të ardhurat tatimore të periudhës janë 202.3 miliardë lekë, 6.1 miliardë lekë më shumë se 6-mujori 2017,

ose me rritje 3.1% kundrejt tij. Krahasuar me planin e 6-mujorit të parë 2018, niveli i realizimit është 98%. Në këtë gjashtëmujor, mbi të ardhurat tatimore të buxhetit kanë ndikuar pozitivisht dhe negativisht një sërë faktorësh.

- Rritja ekonomike në 3-mujorin e parë të vitit për 4.45% ka ndikuar pozitivisht në konsolidimin e të hyrave të buxhetit nga sistemi tatimor.
- Lufta kundër informalitetit dhe punës së padeklaruar, e kombinuar kjo me një fushatë të gjerë edukimi, kontrolli dhe verifikimi, ka dhënë ndikim mjaft pozitiv në vetëdeklarimin e punëmarrësve dhe sigurimin e të punësuarve. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë rritur me mbi 8.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke tejkaluar në këtë mënyrë edhe efektet e rritjes ekonomike.
- Negativisht në të ardhurat tatimore të gjashtë mujorit të parë ka ndikuar ndryshimi i kursit të këmbimit të monedhave të huaja euro dhe USD, kundrejt lekut. Ky ndikim ka qenë i ndjeshëm në reduktimin e bazës së llogaritjes së TVSH-së në import, rrjedhimisht të të ardhurave nga TVSH-ja. Efekti i llogaritur nga ndryshimet e kursit në gjashtëmujorin e parë është 4 miliardë lekë TVSH.
- Ndërkohë, nisur nga situata energjetike e vitit 2017, si rezultat i së cilës ndërmarrjet e sistemit energjetik (KESH dhe OSHEE) u detyruan të importojnë sasi të mëdha energjie me kosto më të lartë se energjia e gjeneruar në vend, ndikoi në uljen e rezultatit financiar të tyre (fitimin) dhe rrjedhimisht edhe kontributin fiskal në buxhet, e cila u reflektua në vitin 2018, pas depozitimit të bilancit. Efekti në të ardhurat e munguara të buxhetit llogaritet në 1 miliard lekë. Gjithsesi kjo situatë parashikohet të përmirësohet si rezultat i rritjes së sasive të energjisë të gjeneruara nga HEC-et në vend dhe kufizimit të ndjeshëm të importeve në vitin 2018, gjë që do të ndikojë në rritjen e treguesve ekonomikë të ndërmarrjeve të sistemit.

Nëse marrim parasysh këta faktorë objektivë, rritja e të ardhurave tatimore krahasuar me vitin e kaluar do të rezultonte 6%. Administrata fiskale po punon intensivisht për rikuperimin e deficitit, duke shtuar përpjekjet për rritjen e nivelit të administrimit në kontrollin e mallrave të akcizës, formalizimit të veprimtarive në fushën e turizmit, kontrollin e detyrimeve tatimore që lidhen me fluksin e investimeve që tashmë kanë filluar dhe do të fillojnë, si dhe për nxitjen e çdo operatori ekonomik për rritjen e vetdeklarimit dhe pagimit të detyrimeve tatimore.

Nisur nga analiza e gjashtëmujorit të parë, si dhe parashikimit të faktorëve që do të ndikojnë situatën e të ardhurave në gjashtëmujorin e dytë, kemi paraqitur në këtë akt normativ disa ndryshime dhe lëvizje brenda zërave të të ardhurave tatimore, me qëllim reflektimin e fakteve që kanë ndodhur dhe nxitjen e punës për përmirësimin e situatës në lloje të caktuara të të ardhurave buxhetore.

3. Ecuria e treguesve kryesorë buxhetorë

Shpenzimet e përgjithshme publike, për muajin e gjashtë të vitit 2018, arritën në rreth 214.7 miliardë lekë me një realizim në masën rreth 95.2 për qind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 ky zë ka rezultuar 2.6 për qind më i lartë ose rreth 5.5 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 6-mujorin e vitit 2018 u realizuan në masën 43.2 për qind të planit vjetor.

Shpenzimet korente dhe ato kapitale kanë shënuar një realizim optimal, respektivisht në masën 97.1 për qind dhe 88.1 për qind të planit të periudhës. Ndërkohë që, *në terma vjetorë* ato janë realizuar përkatësisht në rreth 45.3 për qind dhe 34.6 për qind të tij.

Tabela 1: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 6-mujorin e vitit 2018 (në milionë lekë).

Emertimi	Qershor 2018		Diferenca		Viti 2018	
	Plan	Fakt	Fakt-Plan	ne % mbi Plan	Plani Vjetor	% e realizimit vjetor
Te Ardhurat e Përgjithshme	224,480	216,949	-7,531	96.6%	464,702	46.7%
Shpenzimet e Përgjithshme	225,592	214,665	-10,927	95.2%	497,069	43.2%
Shpenzimet Korente	190,270	184,752	-5,518	97.1%	407,981	45.3%
Shpenzimet Kapitale	33,952	29,913	-4,039	88.1%	86,388	34.6%
Deficit/Suficit	-1,112	2,284	3,396	-205.4%	-32,367	-7.1%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Tabela 2: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 6-mujorin e vitit 2017 dhe 2018 (në milionë lekë).

Emertimi	Fakt Qershor 2017	Plan 2018	Fakt 2018	Diferenca		Diferenca	
				Fakt 2018 Plan 2018	Ne % ndaj Plan 2018	Fakt 2018 Fakt 2017	Ne % ndaj Fakt 2017
Te Ardhurat e Përgjithshme	212,221	224,480	216,949	-7,531	96.6%	4,728	102.2%
Shpenzimet e Përgjithshme	209,175	225,592	214,665	-10,927	95.2%	5,490	102.6%
Shpenzimet Korente	180,902	190,270	184,752	-5,518	97.1%	3,850	102.1%
Shpenzimet Kapitale	26,421	33,952	29,913	-4,039	88.1%	3,492	113.2%
Deficit/Suficit	3,046	-1,112	2,284	3,396	-205.4%	-762	75.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)


Të ardhurat e përgjithshme, për muajin e gjashtë të vitit 2018, arritën në rreth 216.95 miliardë lekë me një realizim në masën rreth 96.6 për qind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 ky zë ka rezultuar 2.2 për qind më i lartë ose rreth 4.7 miliardë lekë më shumë. *Në terma vjetorë*, të ardhurat e përgjithshme për 6-mujorin e vitit 2018 u realizuan në masën 46.7 për qind të planit vjetor.

Shpenzimet korente për periudhën 6-mujore të vitit 2018 rezultuan në rreth 184.75 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 2.1 për qind më i lartë ose 3.85 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet kapitale për muajin e gjashtë të vitit 2018 paraqesin një realizim në masën rreth 29.9 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë është 13.2 për qind më i lartë ose rreth 3.5 miliardë lekë më shumë.

Niveli i suficitit në muajin e gjashtë të vitit 2018 rezultoi në rreth 2.28 miliardë lekë ose rreth 762 milionë lekë më i ulët se e njëjta periudhë e një viti më parë, ose 25 për qind më pak.


Grafiku 1: Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)


Shpenzimet korente në raport me planin 6-mujor të këtij viti paraqesin një realizim prej 97.1 për qind, duke rezultuar në rreth 184.75 miliardë lekë. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente kundrejt planit 6-mujor janë përkatësisht: shpenzimet e personelit me rreth 93.5 për qind, shpenzimet për fondet speciale me 97.1 për qind dhe shpenzimet operative mirëmbajtjeje me rreth 91.8 për qind. Niveli i realizimit të shpenzimeve publike është shoqëruar me një nivel suficiti prej rreth 2.28 miliardë lekësh.

Grafiku 2: Shpenzimet korente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)




Shpenzimet e personelit gjatë muajit qershor 2018 përfaqësuan rreth 19.8 për qind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 36.5 miliardë lekësh realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 6-mujore, në masën rreth 93.5 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë është 4.4 për qind më i lartë ose rreth 1.5 miliardë lekë më shumë.

Grafiku 3: Shpenzimet e personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Shpenzimet për paga në fund të muajit të gjashtë të vitit 2018 u realizuan në masën rreth 31.1 miliardë lekë, duke qenë 3.2 për qind më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2017 ose 952 milionë lekë më shumë. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në masën rreth 4.4 për qind më të larta se një vit më parë ose 216 milionë lekë më shumë. Realizimi faktik i këtyre zërave së bashku është në nivelin rreth 93.5 për qind krahasuar me planin e periudhës ose 46.3 për qind e planit vjetor.


Grafiku 4: Shpenzimet e pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për interesa gjatë periudhës 6-mujore 2018 kanë përfaqësuar rreth 8.3 për qind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 93.4 për qind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, në nivel 6-mujori këto shpenzime janë realizuar në masën rreth 37.1 për qind të tij, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë ka rezultuar 7.7 për qind më i lartë ose rreth 1.1 miliardë lekë më shumë.


Grafiku 5: Shpenzimet për interesa (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë periudhës 6-mujore 2018 kanë shënuar një realizim në masën rreth 18.5 miliardë lekë ose rreth 91.8 për qind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 40.7 për qind të planit vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë ka rezultuar 1.3 për qind më i lartë ose 245 milionë lekë më shumë.


Grafiku 6: Shpenzimet operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për subvencione, në fund të muajit të gjashtë të vitit 2018, arritën nivelin 479 milionë lekë, me një realizim në masën rreth 66.6 për qind ose 240 milionë lekë më pak se plani i periudhës. Në raport me planin vjetor, ky zë është realizuar në masën 22.9 për qind, ndërkohë që kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për subvencione rezultojnë 43.3 për qind më të ulëta ose 366 milionë lekë më pak.

Grafiku 7: Shpenzimet për subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për sondet speciale për muajin e gjashtë të vitit 2018 rezultuan në nivelin rreth 78.2 miliardë lekë, me një realizim prej rreth 97.1 për qind kundrejt planit të periudhës. Përkatësisht, shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 57.9 miliardë lekë dhe shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 19.5 miliardë lekë. Kundrejt të njëjtës

periudhë të vitit 2017, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 1.7 miliardë lekë më të larta, ndërsa shpenzimet për sigurime shëndetësore janë rreth 1.2 miliardë lekë më të larta.

Grafiku 8: Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për papunësinë për 6-mujorin e vitit 2018 janë realizuar në masën rreth 51.8 për qind e planit të periudhës ose rreth 19.6 për qind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën rreth 19.5 për qind ose 38 milionë lekë më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë (PAK) për periudhën 6-mujore të vitit 2018 u realizuan në masën rreth 93.5 për qind ose 654 milionë lekë më pak kundrejt planit të periudhës. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën rreth 45.5 për qind të tij. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 3.3 për qind ose 315 milionë lekë më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë për periudhën 6-mujore të vitit 2018 u realizuan në masën rreth 24.4 për qind ose 711 milionë lekë më pak kundrejt planit të periudhës. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën rreth 11.5 për qind të tij. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 80.8 për qind ose 966 milionë lekë më pak në terma nominalë.


Grafiku 9: Shpenzimet për ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për pushtetin vendor, gjatë periudhës 6-mujore të vitit 2018 kanë përbërë rreth 14 për qind të shpenzimeve korente. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2017 ky nivel rezulton rreth 1.95 miliardë lekë më i lartë ose 8.1 për qind më shumë. Kjo rritje vjen në kuadër të përforsimit të rolit të njësive të reja/të riorganizuara të qeverisjes vendore.

Grafiku 10: Shpenzimet e pushtetit vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet kapitale, në vijim të analizës së ecures së realizimit të investimeve publike, për muajin e gjashtë të vitit 2018 është konstatuar një realizim në masën rreth 29.9 miliardë lekë ose 88.1 për qind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Respektivisht, projektet e investimeve me financim të brendshëm kanë shënuar një realizim në masën rreth 18.9 miliardë lekë ose rreth 93.2 për qind të planit të periudhës, ndërkohë që ato me financim të huaj kanë shënuar një realizim në masën rreth 10.7 miliardë lekë ose 79.8 për qind të planit të periudhës.

Krahasuar me planin vjetor, për 6-mujorin e vitit 2018 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i investimeve publike në masën rreth 29.9 për qind të planit vjetor total.


Financimi i brendshëm dhe financimi i huaj janë realizuar përkatësisht në masën rreth 34.2 për qind dhe 35.1 për qind të planeve vjetore respektive.

Grafiku 11: Shpenzimet kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)


Grafiku 12: Shpenzimet kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e **shpenzimeve publike faktike** për 6-mujorin e vitit 2018. Shpenzimet korente për këtë periudhë përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale faktike me 86.1 për qind, kurse shpenzimet kapitale përbëjnë 13.9 për qind.


Grafiku 13: Detajimi i shpenzimeve buxhetore (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Sikurse evidentohet nga tabela e treguesve fiskalë të konsoliduar, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme është rreth 214.7 miliardë lekë ose rreth 95.2 për qind kundrejt planit të periudhës. Kjo situatë është shoqëruar me një suficit buxhetor prej rreth 2.28 miliardë lekësh. Grafiku i mëposhtëm tregon tendencat pozitive të treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit.

Grafiku 14: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficitit/suficiti - Plan vs Fakt 2018 (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

C. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV

Bazuar në performancën makrofiskale e buxhetore të 6-mujorit të parë të vitit 2018, si edhe në parashikimin e pritshëm të këtyre treguesve deri në fund të këtij viti buxhetor, akti normativ që propozohet konsiston në:

- **Ruajtjen e parametrave kryesorë të buxhetit të miratuar në fillim të vitit.** Deficiti buxhetor mbetet i pandryshuar, ndërkohë që të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit pësojnë sistemime të vogla mes zërave, efekt ky neutral për buxhetin e shtetit.
- **Rialokime brenda zërave të shpenzimeve të buxhetit, kryesisht për:**
 - *Miratimin e një fondi për shpërblimin e pensionistëve dhe familjeve në nevojë, për t'u akorduar në fund të vitit, rezultat i kursimeve nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe parashikimit të rritjes të të ardhurave në këto skema.*
 - *Rialokimin e shpenzimeve kapitale nga projektet me ecuri të ngadaltë tek ato me ecuri të lartë, rialokime të cilat ndihmojnë në avancimin e disa projekteve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe arsimit profesional. Gjithashtu, kemi mbështetur sektorin energjitik përmes rritjes me 1.5 miliardë lekë financimin e huaj. Së fundi, është mbështetur me 1 miliard lekë fondi për zhvillimin rajonal (FZHR).*
 - *Rialokime mes zërave të shpenzimeve korente dhe kapitale për të akomoduar nevojat për inceneratorin e Tiranës;*
 - *Rialokimi mes zërave të shpenzimeve të personelit për të akomoduar nevojat e Gardës së Republikës dhe Policisë së Shtetit;*
 - *Mbështetje për familjet që përfitojnë nga bonusi i strehimit nëpërmjet rialokimeve të brendshme mes zërave të shpenzimeve buxhetore të programit të strehimit;*
 - *Reduktimin me 300 milionë lekë të pagesës së papunësisë, si rezultat i daljes nga kjo e skemë e një numri të konsiderueshëm të papunësh.*
 - *Ndryshime numri punonjësish pa efekte financiare në buxhet.*

Si konkluzion, në gjykimin tonë, ndryshimi i ligjit të buxhetit të vitit 2018 bën të mundur arritjen e tre objektivave të rëndësishëm *garantimin e shpërblimit të pensionistëve dhe shtresave në nevojë, rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve publike përmes rialokimeve mes zërave të shpenzimeve, rritjen e sigurtë në realizimin e treguesve të buxhetit.*

KËSHILLI I MINISTRAVE